

Interviste ne RTSH, date 23 Janar 2019 :

<https://www.rtsh.al/lajme/gjigandi-boteror-i-naftes-shell-plan-investimesh-ne-shqiperi/>

Cfarë planifikon të bëjë Shell në Bllokun 4?

Shell firmosi vitin e kaluar një kontratë me shtetin shqiptar që synon të kuptojë potencialin e burimeve nëntokësore që ka ky bllok, i cili është zgjatim i bllokut 2 dhe 3 e deri në kufi me Greqinë.

Për këtë qëllim, për të kuptuar potencialin e burimeve nëntokësore, na duhet kryerja e një studimi gjeofizik. Për të krijuar një imazh të qartë të strukturave gjeologjike dhe burimeve të zonës, duhet studiuar një rrjet linjash sizmike. Metoda e vetme e përdorur në industrinë e naftës dhe të gazit është studimi sizmik. Ky studim parashikon vendosjen e disa pajisjeve që quhen gjeofonë, hapjen e vrimave për të krijuar energjinë e duhur për të krijuar vibrimet si dhe makinat e vibrimit. Në këtë metodologji të propozuar ne kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo lloj impakti të mundshëm. Për këtë gjë zbatojmë jo vetëm legjislacionin shqiptar por edhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Përsa i përket shqetësimit që është ngritur nga banorët se ajo që planifikohet të bëhet do ta shkatërrojë Zagorinë, ne po ju informojmë se:

Ka një Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 2 maj 2018 i cili e transformon parkun e Zagorisë në një park natyror kombëtar. Shell do të respektojë deri në fund këtë vendim dhe do të përmbahet kufizimeve që ai përcakton në lidhje me nënzonat e mbrojtura të Parkut. Që do të thotë se pavarësisht rezultateve të studimit sizmik, Shell nuk do të kryejë aktivitete kërkuese e shpuese në nënzonën e mbrojtur të Zagorisë, e cila gëzon një mbrojtje të vecantë nga VKM. Përvec kësaj, Shell i mirëkupton shqetësimet e njerëzve nga përvoja negative të mëparshme të tyre me këtë industri, por ne kemi tashmë një histori pozitive në Shqipëri, në zonën e Shpiragut afër Beratit. Jo vetëm kemi kryer studime sizmike me asnjë impakt negativ në mjedis dhe monumentet kulturore, por kemi bërë edhe shpimin e dy puseve duke mirëmenaxhuar çdo impakt mbi mjedisin dhe komunitetin.

<https://www.rtsh.al/lajme/rama-kerkime-nafte-ne-zagori-nuk-ben-vaki/>